# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-447846**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kush janë katër gjyqtarët që do vendosin sot fatin e ish-krerëve të UÇK-së - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/kush-jane-kater-gjyqtaret-qe-do-vendosin-sot-fatin-e-ish-krereve-te-uck-se/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 07:21:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 07:20:09 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0c42de86d02be004c31c5974143fa822a9fd4bd75ed16c8770c1b87f19246b51` |
| TEKSTI | `74388b7db44e4c74b3df6f3d23c20846d098cb39ce4d4a4de43153b689b9a831` |
| PAMJA | `11dc79e6f90863290deb2ec8178aa181bba0f5696c95f692ec619d3524c90c9f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b5b69cca4814cffe94f93e818876261994b29924aba08806e7a14ccc9b75bf6d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b5b69cca4814cffe94f93e818876261994b29924aba08806e7a14ccc9b75bf6d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | LAJM KRYESOR

# Kush janë katër gjyqtarët që do vendosin sot fatin e ish-krerëve të UÇK-së

LAJMI I FUNDIT

09:19 Perçarje në të djathtën izraelite, Netanyahu dhe Ben-Gvir përplasen për koalicionin e ardhshëm

09:09 “Pafajësi, drejtësi për ish-krerët e UÇK”, ambasadori shqiptar hyn në gjykatën e Hagës

09:04 Shembet ndërtesa 6-katëshe në Gaza, 8 të vdekur dhe mbi 60 persona nën rrënoja

08:57 Katër profilet e ish-krerëve të UÇK-së që presin sot vendimin në Hagë, nga Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi

08:56 FBI: Rusia po rekruton persona për të vrarë aleatët e Ukrainës në SHBA dhe Evropë

08:50 Sulmet ndaj infrastrukturës energjetike saudite rrisin çmimin e naftës, ndërpritet transporti detar në Gjirin Persik

16 Shtator 2026 | 09:20

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Pas më shumë se tre vitesh proces gjyqësor, Gjykata Speciale në Hagë pritet të shpallë sot, në orën 10:00, aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Vendimi do të shpallet nga Trupi Gjykues II, i përbërë nga tre gjyqtarë me të drejtë vote dhe një gjyqtar rezervë. Në krye të trupit është amerikani Charles L. Smith III, ndërsa anëtarë janë gjermani Christoph Barthe dhe zvicerani Guénaël Mettraux. Gjyqtari irlandez Fergal Gaynor është caktuar si gjyqtar rezervë.

**Charles L. Smith III – Kryesuesi i trupit gjykues**

Në krye të trupit gjykues është gjyqtari amerikan Charles L. Smith III. Ai ka një karrierë të gjatë në sistemin gjyqësor amerikan dhe ka shërbyer për vite si gjyqtar në shtetin e Iowa-s.

Smith ka shërbyer gjithashtu si gjyqtar i EULEX-it në Kosovë, përfshirë Gjykatën Supreme të Kosovës. Në Dhomat e Specializuara të Kosovës ai është kryesues i trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

**Christoph Barthe – Gjyqtari gjerman**

Pjesë e trupit gjykues është edhe gjyqtari gjerman Christoph Barthe.

Barthe ka një përvojë të gjatë në drejtësinë penale dhe ndërkombëtare. Ai ka shërbyer si prokuror publik në Gjykatën Federale të Drejtësisë në Gjermani, ku është marrë edhe me çështje që lidhen me krimet e luftës dhe gjenocidin.

Ai ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar provat dhe dëshmitë gjatë procesit ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së.

**Guénaël Mettraux – Gjyqtari zviceran**

Gjyqtari zviceran Guénaël Mettraux është një tjetër anëtar i trupit gjykues.

Ai ka një karrierë të lidhur ngushtë me të drejtën penale ndërkombëtare. Mettraux ka punuar në çështje që lidhen me krimet e luftës dhe ka pasur përvojë si avokat mbrojtës dhe këshilltar përpara disa gjykatave ndërkombëtare.

TESTIM

Ai ka shërbyer gjithashtu në struktura të drejtësisë ndërkombëtare dhe është profesor i së drejtës penale ndërkombëtare.

**Fergal Gaynor – Gjyqtari rezervë**

Gjyqtari irlandez Fergal Gaynor është pjesë e trupit gjykues në cilësinë e gjyqtarit rezervë.

Gaynor ka përvojë të gjatë në drejtësinë ndërkombëtare dhe ka punuar në çështje që lidhen me krimet e luftës. Ai ka shërbyer në procese pranë Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën dhe Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

Në këtë proces, Gaynor ka rolin e gjyqtarit rezervë të trupit gjykues.

---

**Shiko në:**


## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

**“Pafajësi, drejtësi për ish-krerët e UÇK”, ambasadori shqiptar hyn në gjykatën e Hagës**

Ambasadori i Shqipërisë në Holandë, Artur Kuko këtë të mërkurë është bashkuar me dhjetëra mbështetës të ish-krerëve të UÇK-së për të marrë pjesë në seancën...

09:09 | 16/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | RAJONI

**Katër profilet e ish-krerëve të UÇK-së që presin sot vendimin në Hagë, nga Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi**

Katër prej figurave më të njohura të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës presin sot në Hagë vendimin përfundimtar të gjykatës. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi...

08:57 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

**Pritet vendimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, policia largon djalin e Thaçit nga hyrja e gjykatës! Gazetarja jep detajet**

Këtë të mërkurë pritet të jepet vendimi në Gjykatën Speciale në Hagë për ish-krerët e UÇK-së. Lidhur me këtë vendim të rëndësishëm, dhjetëra persona kanë udhëtuar...

08:34 | 16/09/2026





Copyright © Euronews 2026


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.